



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-020/04-158560/23 më 03. 08. 2023

Në bazë të neneve 13 dhe 26 të Ligjit nr.03/L- 040, për vetëqeverisje lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15, qershor 2008), të nenit 20 të ligjit nr.06/L- 021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin sektorit publik, të nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.Nr.110 -391 te dt 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET vendimi për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të auditimit për Komunën e Prishtinës.

II. Komitetin e Auditimit të Brendshëm nga pika 1 e këtij Vendimi e përbëjnë:

1. Rita Hajzeraj - Ukaj - Kryesuese
2. Visar Perjuci - Anëtar dhe
3. Islam Hasani - Anëtar

III. Drejtori i Njësisë së auditimit të brendshëm do të jetë sekretari i komitetit te cekur në pikën I të vendimit, në cilësinë e përcjellësit të takimit të Komitetit.

IV. Mandati i anëtarve të Komitetit të auditimit të cekur në pikën II të këtij vendimi është tre (3)vjeçare, më të drejtë riemërimin dhe për një mandat tre(3) vjeçare.

V. Detyrë e komitetit të cekur në pikën I të këtij Vendimi është: ofrimi i këshillave të menaxhmentit për KBFP, të sigurojë që menaxhmenti i SSP-së realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore, të rishikojë dhe aprovoj planet vjetore të NJAB, të rishikojë raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, deklaratat financiare, përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ndritura nga auditimi i jashtëm, të mbrojnë pavarësinë funksionale të NJAB dhe detyra tjera të parapara nga pikat 1.9 deri te pika 1.14 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin sektorit publik.

VI. Komiteti i auditimit të përgatit raportin vjetor për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik. Raporti duhet të përfshijë pjesët e parapara nga pika 1,1 deri te pika 1.7 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin sektorit publik.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi i Kryetarit të Komunës, 14-470/03-38251/23, i dt. 16 prill 2023.

IX. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të Komitetit;
- Drejtorit të NJAB, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

KRYETARI I KOMUNËS

Përparim Rama



